



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, maj 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Graçanicës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Graçanicës (KG), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Graçanicës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar në RFV për vlerën prej 1,418,635€.
- B2 Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve në kategoritë ekonomike në vlerë 282,706€.
- B3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale nuk janë prezantuar saktë në RVF, si dhe stoqet ishin nënvlerësuar për 528,666€, për shkak të mos regjistrimit të tyre.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Graçanicës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B4 Mungesë e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 41,700€.
- A1 Përcaktimi i devijimit prej 30% në kontratë publike kornizë me çmim për njësi.
- A2 Përzgjedhja e OJQ-së jo në pajtim me kriteret e Thirrjes Publike.
- C1 Mos harmonizimi i kontratave të punës/akt emërimeve sipas kërkesave ligjore.
- B5 Në 21 raste kemi vërejtur se stafi arsimor dhe shëndetësor nuk janë sistemuar në vendin e punës sipas kontratës.
- B6 Aplikimi i koeficientit jo në pajtueshmëri me ligjin për paga.
- B7 Vonesa në kryerjen e obligimeve dhe pagesa shtesë për shpenzimet përmbartimore/ gjyqësore.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Graçanicës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Graçanicës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Graçanicës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Graçanicës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Graçanicës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keqklasifikim të shpenzimeve, mangësi në prokurim, dobësi në subvencione dhe transfere, mangësi në lidhje me menaxhimin e pasurive dhe stokeve, mangësi me prezantimin e llogarive të arkëtueshme, menaxhim jo të mirë të kontratave, vonesa në pagesën e faturave, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalljet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollin e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja, një (1) pjesërisht i përsëritur dhe 11 të përsëritura.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Nënvlërësimi i llogarive të arkëtueshme në RFV

Gjetja

Neni 16 i Rregullores MF-nr.01/2017 për raportim vjetor financiar për organizata buxhetore përcakton "OB-të që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të plotë për shumatat e paarkëtuara".

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në RVF (6,757,134€), ishin nënvlërësuar për 1,418,635€, si rrjedhojë e mos prezantimit të plotë të borxheve të paarkëtuara nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë nga vitet e mëparshme. Në RVF në kuadër të akrëtueshmeve për taksa për ushtrimin e veprimtarisë, komuna kishte prezantuar vetëm llogaritë e arkëtueshme për vitet 2022-2025, në vlerë prej 888,280€, por jo edhe të arkëtueshmet nga vitet tjera. Përkundër faktit se kjo dukuri e përcjell komunën për vite radhazi dhe janë dhënë rekomandime për zbatim, nga ana e komunës nuk është marrë ndonjë veprim për raportim dhe shpallje të saktë të këtyre llogarive.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së koordinimit efektiv ndërmjet Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorisë për Financa, për të harmonizuar shënimet për llogaritë e arkëtueshme.

Ndikimi

Mos prezantimi dhe shpallja jo e saktë e llogarive të arkëtueshme ndikon në raportim jo të drejtë dhe të saktë të informatave financiare, respektivisht në nënvlërësimin e tyre në RFV.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontroleve të brendshme, në mënyrë që të përmirësohet procesi i menaxhimit, prezantimit të drejtë dhe shpalljes së llogarive të arkëtueshme në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Keqklasifikim i shpenzimeve**Gjetja**

Neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se “Shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël”. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t’i aplikojnë.

Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 282,706€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas vendimit përmbartimor/ të gjykatës nga kategoria mallra dhe shërbime për kategorinë investime kapitale 95,974€, dhe për subvencione dhe transfere 3,548€. Po ashtu nga kategoria Mallra dhe shërbime komuna kishte paguar 183,184€, për kategorinë investime kapitale që kanë të bëjë me rikonstruimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale.

Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe hyrjes në obligime pa pasur mjete të mjaftueshme financiare.

Ndikimi

Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpjen në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PVF-ve.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Prezantimi jo i saktë i pasurive komunale dhe stoqeve në RVF**Gjetja**

Neni 6 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore paragrafi 3 parasheh se “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Neni 11 përcakton se “Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim. Pasuritë jo financiare kapitale që janë në fazën e investimeve në vijim nuk zhvlerësohen. Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësisë të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësim”. Po ashtu neni 22 paragrafi 3 i kësaj rregulloreje parasheh se “Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t’i nënshtrohen normave të zhvlerësimit”.

Vlera e pasurive kapitale të prezantuara në Raportin Vjetor Financiar (RFV) që ishte 25,775,690€, nuk është prezantuar saktë. Kjo për shkak se tri (3) pagesa në vlerë 183,184€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë. Poashtu, tetë (8) projekte të përfunduara në vlerë prej 360,046€, ndonëse kanë përfunduar, ende nuk janë transferuar në pasuri në përdorim, me ç’rast nuk ka filluar zhvlerësimi i tyre. Këto projekte vazhdojnë të mbahen

në regjistra si investime në vijim.

Pasuritë jo-kapitale të prezantuara në RVF në vlerë 610,307€, nuk janë të sakta, për shkak se komuna nuk ka aplikuar zhvlerësimin e pasurive në sistemin e e-pasurisë. Përveç kësaj, pasuritë e blera gjatë vitit 2025 nuk ishin regjistruar fare në sistemin e e-pasurisë.

Stoqet e prezantuara në RVF në vlerë prej 6,509€ nuk janë të sakta. Auditimi për vitin 2023, kishte evidentuar se një vlerë e konsiderueshme e stoqeve në shumë 504,118€, e raportuar nga Komisioni i Inventarizimit, nuk ishte regjistruar në regjistrat e komunës. Poashtu, auditimi gjatë vitit 2024 kishte evidentuar se dy pagesa në vlerë 24,548€ për material higjienik, nuk ishin regjistruar. Këto pagesa si dhe pagesat e vitit 2025 nuk janë regjistruar, gjë që tregon për mospërmirësim të gjendjes dhe vazhdim të mungesës së kontrollit dhe raportimit jo të duhur të stoqeve.

Mbajtja jo e saktë e regjistrave të pasurive dhe stoqeve, si dhe mosazhurnimi dhe mosregjistrimi i tyre, ka ndodhur si rezultat i mosangazhimit adekuat të zyrtarëve përgjegjës të pasurisë, për ta menaxhuar pasurinë komunale në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndikimi

Mospërditësimi dhe mosregjistrimi i pasurive dhe stoqeve në regjistrat përkatës ndikon në paraqitjen e drejtë dhe të saktë të tyre në RVF, duke kufizuar kështu ofrimin e informatave të plota dhe të sakta.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet shtuar kontrollet për të siguruar që zyrtarët e pasurive bëjnë azhurnimin e regjistrat të pasurive, si dhe regjistrimin e të gjitha pasurive dhe stoqeve të komunës, në përputhje me kërkesat ligjore në mënyrë që të bëhet raportimi në RVF i saktë dhe i plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B4 - Mungesë e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë

Gjetja Rregulla financiare 03/2010 për të hyrat, përcakton kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake. Neni 8 paragrafi 5 i kësaj rregulle specifikon “OB-të për shërbimet e ofruara duhet të lëshojnë faturë me numër referent i cili numër llogaritet sipas udhëzimeve teknike të cekura në Nenin 3 të Udhëzimit Administrativ 2007/06.

Për 14 mostra të testuara për llogaritë e arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 41,700€, komuna nuk posedon dëshmi burimore si faturë apo ndonjë dokument tjetër që konfirmon shumën e borxhit të prezantuar në RFV.

Mbikëqyrja e pamjaftueshme nga menaxhmenti ndaj stafit përgjegjës ka bërë që dëshmitë mbështetëse për vlerat e llogarive të arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë, të paraqitura në pasqyrat financiare, të mos trajtohet me kujdesin e duhur. Si rezultat, kjo çështje po përsëritet vazhdimisht në raportet e auditimit nga viti në vit.

Ndikimi Mungesa e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë mund të rezultojë në pasaktësi në raportimin financiar dhe të ndikojë në besueshmërinë dhe saktësinë e informacionit financiar të paraqitur.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që të forcohet mbikëqyrja ndaj stafit përgjegjës dhe të ndërmerren veprime për të siguruar dëshmi të mjaftueshme mbështetëse për vlerat e llogarive të arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë të paraqitura në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Përcaktimi i devijimit prej 30% në kontratë publike kornizë me çmim për njësi

Gjetja Rregullorja Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik neni 54 paragrafi 15 parasheh “Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve/artikujve në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë për qind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve, pajisjeve të ndryshme etj”.

Komuna me datën 31.07.2025, kishte lidhur kontratë publike kornizë për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave. Sipas dosjes së tenderit, kontrata ishte paraparë të jepet me peshim sipas çmimit për njësi.

Megjithatë, përkundër faktit se kontrata ishte lidhur me çmim për njësi, ishte paraparë edhe devijimi prej 30%. Duke marrë parasysh natyrën e kontratës me çmim për njësi, nuk është dashur të përcaktohet devijim prej 30%. Vlera

e kontratës është 249,999€.

Kjo ka ardhur si rezultat i mosveprimit të duhur nga zyra e prokurimit për lidhjen e kontratës në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndikimi

Përcaktimi i devijimit prej 30% mund të shkaktojë tejkalim të vlerës së kontratës dhe të krijojë rrezik për menaxhim joefikas të kontratës.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që Zyra e Prokurimit t'i lidhë kontratat në pajtim të plotë me kërkesat ligjore dhe me natyrën e procedurës së prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Përzgjedhja e OJQ-së jo në pajtim me kriteret e Thirrjes Publike

Gjetja

Me 28.09.2025, Komuna kishte bërë shpalljen e Thirrjes publike që kishte të bëjë për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të Organizatave Joqeveritare (OJQ) në fushën e bujqësisë. OJQ-të mund të aplikonin me projekte/programe për aktivitetet si:

Zhvillimi i bujqësisë dhe shtimi i aktiviteteve bujqësore,

Mbrojtja dhe kujdesi ndaj kafshëve (qenve endacakë),

Vaksinimi i qenve kundër tërbimit dhe sterilizimi i qenve që janë në pronësi të personave me vendbanim-vendqëndrim në territorin e Komunës së Graçanicës,

Zbatimi i fushatës për ngritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për përgjegjësinë ndaj kafshëve dhe trajtimin human të tyre, zvogëlimin human të numrit të kafshëve të braktisura, kujdesin për kafshët e braktisura, parandalimin e abuzimit dhe shpëtimin e kafshëve të lënduara dhe ruajtja dhe përmirësimi i fondit të peshkut.

Të drejtën në aplikim kishin OJQ-të të cilat janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare të Republikës së Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Graçanicës dhe që veprojnë dhe janë të regjistruara së paku dy vjet para datës së publikimit të Thirrjes publike. OJQ-ja që dorëzon aplikacionin duhet të paraqesë dëshmi se ka qenë e angazhuar në aktivitete bujqësore gjatë një viti.

Në aplikacionin e projektit/programit kërkohet nga OJQ përshkrimi se si do t'i realizoj aktivitetet që lidhen me objektivat e thirrjes. Gjatë procesit të auditimit kemi konstatuar se është përzgjedhur një OJQ e cila nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen publike.

Në aplikacionin e dorëzuar nga OJQ-ja nuk kemi hasur që kishte përshkrim nga OJQ se si do të realizohen aktivitetet e kërkuara të projektit, përkatësisht:

- Mbrojtja dhe kujdesi ndaj kafshëve;
- Vaksinimi i qenve kundër tërbimit dhe sterilizimi i tyre;
- Zbatimi i fushatës për ngritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve lidhur me përgjegjësinë ndaj kafshëve dhe trajtimin human të tyre; dhe
- Ruajtja dhe përmirësimi i fondit të peshkut.

Pavarësisht kësaj, Komisioni Vlerësues ka konstatuar se OJQ-ja i plotëson kriteret e thirrjes dhe e ka rekomanduar për përkrahje financiare.

Gjithashtu, kemi konstatuar se OJQ-ja është e regjistruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) me fushëveprimtari: Rini, Sport dhe Edukim/Trajnim, të cilat nuk janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me objektivat e thirrjes.

Tutje, në aplikacion kjo OJQ kishte paraqitur si partnere një OJQ tjetër, e cila nuk e plotëson kriterin e përvojës së kërkuar në thirrje, pasi është regjistruar në MPB më 30.04.2025 me fushëveprimtari: Edukim/Trajnim, Bujqësi, Trashëgimi Kulturorë, Zhvillim Social dhe Zhvillim Ekonomik. Vlera e kontratës ishte 20,000€.

Kjo ka ndodhur për shkak se komisioni vlerësues nuk e ka kryer procesin e vlerësimit në përputhje të plotë me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në thirrjen publike.

Ndikimi Si rezultat i përzgjedhjes së një OJQ-je që nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen publike, ekziston rreziku i mosrealizimit të objektivave të projektit dhe mosarritjes së rezultateve të synuara.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet t'i shtojë kontrollet dhe mbikëqyrjen ndaj komisionit vlerësues, me qëllim që të sigurohet se procesi i vlerësimit të projekteve zhvillohet në përputhje të plotë me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në thirrjen publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mos harmonizimi i kontratave të punës/akt emërimeve sipas kërkesave ligjore

Gjetja Neni 102 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, paragrafi 1 parasheh “ Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtareve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës” dhe paragrafi 2 ” Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik”.

Neni 16 i Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, paragrafi 2 specifikon “Paga bazë për nëpunësit e shërbimit publik përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit që përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcat e këtij ligji”.

Nga testimi i 70 mostrave për pagat e personelit, në 28 prej tyre kemi identifikuar se kontratat e punës/akt emërimet e nëpunësve/zyrtarëve të sektorit të shëndetësisë, nuk ishin përditësuar për të reflektuar nivelin e saktë të pagës bazë - koeficientit. Përkundër faktit se pagat e këtyre nëpunësve/zyrtarëve ishin përlogaritur sipas ligjit për pagat, megjithatë kjo nuk ishte përcjellur me harmonizim edhe në kontratat e tyre të punës/akt emërimet.

Sipas konfirmimit që kemi pranuar nga drejtoria komunale e shëndetësisë, janë duke vazhduar me procesin e harmonizimit dhe se deri në periudhën aktuale afërsisht vetëm gjysma e kontratave janë përditësuar.

Ndikimi Kjo situatë ndikon në mos respektimin e kërkesave ligjore dhe krijon paqartësi, pasi që kontrata e punës/akt emërimi nuk paraqet nivelin e saktë

të pagës bazë-koeficientit.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë se kontratat e punës/akt emërimet për nëpunësit/zyrtarët komunal përditësohen dhe harmonizohen sipas kërkesave dhe afateve ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Sistemimi i stafit të sektorit të arsimit dhe shëndetësisë jo në përputhje me kontratat e punës

Gjetja

Neni 17 paragrafi 1 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212 përcakton “I punësuari caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune”. Ndërkaq, paragrafi 2 parasheh

“Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuari në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës”.

Neni 84 paragrafi 1 i këtij Ligji thekson “I punësuari është i detyruar që në vendin e punës t’iu përmbahet detyrimeve të parapara me ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës”. Poashtu, sipas Strukturës Organizative dhe Rregullores për organizim të brendshëm të Administratës Komunale është i përcaktuar organizimi i brendshëm dhe mënyra e marrjes së akteve të brendshme për sistematizimin e punëve.

Nga 70 mostra të testuara për pagat e personelit, në 21 prej tyre kemi identifikuar se stafi arsimor dhe shëndetësor si: mësimdhënës, administrator, staf teknik mbështetës dhe mirëmbajtës, psikolog, shofer, nuk janë sistemuar në vendin e tyre të punës në përputhje me kontratën. Sistemimi i stafit në pozita dhe drejtori të tjera për dallim nga kontrata e punës, ishte bërë përmes vendimeve për sistematizim të përkohshëm me arsyetimin e rritjes së vëllimit të punëve. Sistemimi i stafit ishte bërë pa ndonjë afat të caktuar në departamentin e arsimit dhe kulturës, shtëpi të kulturës, drejtori për shërbime publike, administratë komunale, drejtori të inspeksionit, drejtori të urbanizimit, drejtori të zhvillimit ekonomik, drejtori të shëndetësisë si dhe institucione parashkollore, në pozitat si : inspektor, mbështetës administrativ, referent, zyrtar për informim të publikut, administrator. Ndërsa përkundër sistemimit, pagesa e pagave për këta zyrtar ishte bërë sipas ligjit për paga dhe kontratës së punës. Po ashtu, për 21 rastet e identifikuara nuk kemi pranuar objektiva të punës për vitin 2025 dhe rrjedhimisht as raporte të punës.

Nga listat e stafit që na janë ofruar, në total figurojnë 262 zyrtarë ku prej tyre 228 nga sektori i arsimit dhe 34 nga sektori i shëndetësisë që janë sistemuar në pozita dhe drejtori tjera.

Sipas zyrtarëve përkatës nga drejtoria komunale e arsimit dhe shëndetësisë, kjo kishte ndodhur për shkak të numrit të pamjaftueshëm të pozitave të aprovuara të zyrtarëve në departamentet e caktuara të cilët i kanë pamundësuar rekrutimin e punëtorëve të rinj në proporcion me nevojat e komunës.

Ndikimi

Sistemimi i stafit jo në përputhje me pozitën sipas kontratave të punës paraqet shkelje të kërkesave ligjore dhe ndikon në nivel të ulët të përgjegjësisë dhe cilësisë në kryerjen e detyrave që rrjedhin nga

marrëdhënia e punës.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se stafi arsimor dhe shëndetësor të jetë i angazhuar në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë sipas kontratës së punës. Gjithashtu duhet të krijohet harmonizim në mes të pozitive aktuale dhe atyre të buxhetuara në përputhje me ligjin për ndarje buxhetore i cili i përgjigjet nevojave të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B6 - Aplikimi i koeficientit jo në pajtueshmëri me ligjin për paga

Gjetja Neni 16 i Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, paragrafi 2 specifikon “Paga bazë për nëpunësit e shërbimit publik përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit që përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcat e këtij ligji”.
Neni 102 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, paragrafi 1 parasheh “ Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtareve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës” dhe paragrafi 2 ” Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik”.

Për një (1) rast kemi identifikuar se nuk ishte aplikuar drejt dhe saktë koeficienti në pagë, sipas shtojcave të ligjit për paga në sektorin publik. Në rastin konkret, për zyrtarin komunal ishte aplikuar koeficienti 4.8 duke e klasifikuar në pozitën e nëpunësit administrativ, përderisa me kontratë të punës zyrtari ishte me pozitë dhe detyra koreograf dhe do duhej të klasifikohet dhe paguhej me koeficient 8 sipas përcaktimit në shtojcën e ligjit për krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe artit.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e dobësive të kontrollit të brendshëm për të aplikuar drejtë dhe saktë koeficientin e përcaktuar sipas ligjit për paga si dhe për të reflektuar kërkesat ligjore edhe në kontratën e punës.

Ndikimi Kjo situatë shkakton mos respektim të kërkesave ligjore, trajtim jo të barabartë dhe dëmtim financiar në pagën e zyrtarit komunal.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarit komunal i aplikohet koeficienti i drejt në pagë sipas përcaktimit ligjor. Po ashtu, në formë rektroaktive zyrtarit t’i kompensohet diferenca e pagës për të cilën nuk është paguar sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B7 - Vonesa në kryerjen e obligimeve dhe pagesa shtesë për shpenzimet përmbare/gjyqësore**Gjetja**

Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore". Po ashtu neni 40.3 i Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit parash "Pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm ose urdhrin të formës së prerë, Ministria është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që menjëherë të marrë çfarëdo masa të nevojshme për pagimin e vendimit ose urdhrin nga ndarjet buxhetore në dispozicion; me kusht që nëse vendimi i plotfuqishëm është nxjerrë kundër një komune, vetëm përvetësimet e komunës mund të shfrytëzohen për përmbaremin e këtij vendimi".

Në tetë (8) rastet kishte vonesa në pagimin e obligimeve të papaguara. Vonesat tejkalojnë periudhën prej 30 ditësh nga periudha e përcaktuar ligjore.

Për shkak të mos kryerjes së obligimeve me kohë, për vitin 2025, thesari sipas vendimeve përmbare/gjyqësore kishte ekzekutuar 679,992€, pagesa nga buxheti i komunës. Prej tyre, borxhi kryesor ishte 665,336€, ndërsa 14,656€, ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës përmbare/gjyqësore dhe interesit.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e obligimeve kanë shkaktuar kosto shtesë, përveç vlerës së faturës komuna kishte paguar kosto shtesë përfshirë kamatën dhe shpenzimet tjera procedurale gjyqësore/përmbare.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të siguroj se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,371,035€, prej tyre ishin shpenzuar 2,556,186€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimin e objekteve arsimore dhe shëndetësore, banimit social, rregullimin e parqeve.

Çështja A3 - Mosnënshkrimi i planeve të menaxhimit të kontratave

Gjetja Neni 81 i Ligjit të Prokurimit Publik parasheh se “ Autoritetet Kontraktuese duhet të prodhojnë një plan të menaxhimit të kontratës dhe se plani i menaxhimit duhet të jetë i rënë dakord midis palëve të kontratës dhe të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës”. Po ashtu neni 45 paragrafi 35.4 i Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.001/202 Për Prokurimin Publik specifikon se “Kontrata do të ekzekutohet në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës dhe planin e menaxhimit të kontratës sipas nenit 81 të LPP”.

Për pesë (5) kontrata kemi identifikuar se plani i menaxhimit i vendosur në e-prokurim nuk është nënshkruar nga palët e kontratës respektivisht menaxheri i projektit nga ana e komunës si dhe menaxheri i projektit nga ana e operatorit ekonomik. Këto kontrata kanë të bëjnë me:

- Furnizimi me karrige stomatologjike dhe pajisje shoqëruese, në vlerë prej 39,990€;
- Rikonstruimin, rehabilitimin dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në Komunën e Graçanicës, në vlerë prej 466,912€;
- Furnizimin e një automjeti të përshtatur për transportin e personave me aftësi të kufizuara, në vlerë prej 59,800€;
- Furnizim me autoambulancë, në vlerë 72,600€; dhe
- Furnizim me reagenca për laborator, në vlerë 82,316€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i dobësive të kontrollit të brendshëm për t'i mbikëqyrë menaxherë e projekteve për ta nënshkruar planin e menaxhimit dhe për t'i vendosur në platformë e-prokurimit.

Ndikimi Mosnënshkrimi i planeve të menaxhimit të kontratave krijon hapësirë për mos menaxhim të rreziqeve që potencialisht mund të rrjedhin gjatë zbatimit të kontratës, si dhe shmangie të përgjegjësisë së palëve për përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë që planet e menaxhimit të kontratave të nënshkruhen nga palët kontraktuese si kusht për zbatimin e kontratës dhe të vendosen në platformën e e-prokurimit, sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Menaxhimi i kontratave jo përmes platformës së prokurimit**Gjetja**

Rregullorja Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik neni 70.24 pika (f) thekson se menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Menaxherët e kontratave/projekteve për vitin 2025, nuk e kanë mbajtur menaxhimin e kontratave përmes sistemit elektronik të prokurimit.

Kjo ka ndodh si rezultat i dështimeve të menaxherëve të kontratave për t'i menaxhuar kontratat përmes sistemit të prokurimit.

Ndikimi

Mosmenaxhimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të kërkojë dhe sigurojë nga të gjithë menaxherët e projekteve që menaxhimi i kontratave të bëhet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B9 - Mosrespektimi i afatit ligjor për pranimin e tenderëve****Gjetja**

Neni 44 i Ligjit të Prokurimit Publik ndër të tjera parasheh se "Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve. Kur kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se 40 ditë", ndërsa për kontratat me vlerë të mesme sipas Udhëzues nr.002/2024, për plotësim ndryshimin e Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik është 20 ditë. Po ashtu neni 46 i këtij ligji nder tjera parasheh se " Nëse ekzistojnë rrethanat që: (i) kërkojnë zbatimin e një aktiviteti të prokurimit në raste urgjente; (ii) e bëjnë të pamundur respektimin e afateve kohore të përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji ose nëse është e aplikueshme edhe në nenin 45 të këtij ligji; (iii) nuk shkaktojnë urgjencat e parashikuara nga neni 35.2.1, autoriteti kontraktues mundet të zbatojë prokurimin me përdorimin e afateve të përshpejtuara kohore që përcaktohen me këtë nen".

Zyra e Prokurimit për dy aktivitete të prokurimit me procedurë të hapur për kontratë furnizimi, nuk kishte respektuar kërkesën ligjore në lidhje me afatin për pranimin e tenderëve. Te kontrata që kishte të bëjë me "Furnizim i një automjeti të përshtatur për transportin e personave me aftësi të kufizuara", në vlerë prej 59,800€ afati i dorëzimit ishte 10 ditë ndërsa te kontrata "Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës" në vlerë 1,172,455€, afati i dorëzimit të tenderve ishte 17 ditë. Në dosjen e prokurimit, ne nuk kemi vërejtur se kishte ndonjë arsye relevante që ka shtyrë komunën në mosrespektimin e afatit ligjor.

Përkundër faktit se afatet kohore ishin përshpejtuar dhe se vetura ishte pranuar në fund të vitit 2025 nga komisioni pranues dhe menaxheri i kontratës, duke konfirmuar se ajo ishte në përputhje me specifikimet e

kontratës, gjatë ekzaminimeve fizike në terren të realizuara në periudhën shkurt 2026 u konstatua se vetura ndodhej në riparim në servisën e operatorit ekonomik. Po ashtu, u evidentua se vetura nuk ishte e siguruar, e regjistruar dhe as funksionale, rrjedhimisht ishte e pashfrytëzueshme. Kjo situatë kishte ardhur si rezultat i mos-përmbushjes së kërkesave teknike për bartjen e personave me aftësi të kufizuara dhe nevojës për ndërhyrje dhe riparime shtesë.

Vlen të theksohet se deri në përfundim të punës tonë audituese në teren në fillim të periudhës mars 2026, vetura nuk ishte e regjistruar dhe funksionale në përdorim të personave për të cilët ishte dedikuar.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të pamjaftueshme brenda Zyrës së Prokurimit për të siguruar respektimin e kërkesës ligjore lidhur me afatin për pranimin e ofertave/tenderëve.

Ndikimi

Mosrespektimi i afateve ligjore për pranimin e tenderëve për aktivitetet e prokurimit me procedurë të hapur për kontrata me vlera të mesme, pa ndonjë arsye të bazuar mjaftueshëm, mund të ndikoj në kufizimin e konkurrencës duke ulur mundësitë për pjesëmarrje të barabartë të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe të pamundësojë përgatitjen dhe dorëzimin me kohë dhe në mënyrë të plotë të ofertave.

Rekomandimi B9

Kryetari duhet të forcojë dhe shtojë kontrollet për të siguruar që Zyra e Prokurimit të respektojë plotësisht afatet ligjore të përcaktuara për pranimin e tenderëve, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe konkurrues në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 25,775,690€, pasurive jokapitale është 610,307€, si dhe e stoqeve 6,509€.

Çështja B10 - Mos formimi i komisionit të inventarizimit të pasurive jofinanciare dhe mos realizimi i inventarizimit

Gjetja

Neni 18 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore nder të tjerash parasheh se “Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare”.

Komuna nuk kishte formuar komisionin për inventarizimin e pasurive komunale jofinanciare. Rrjedhimisht, nuk ishte kryer inventarizimi i pasurisë për vitin 2025.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrollit të duhur nga ana e menaxhmentit të lartë komunal, për të formuar komisionin për inventarizimin e pasurive jofinanciare, i cili komision do të realizonte inventarizimin e pasurisë.

Ndikimi

Mos formimi i komisionit të inventarizimit të pasurive komunale jofinanciare dhe mos realizimi i inventarizimit, rrit rrezikun për një prezantim të pasaktë dhe jo të drejtë të tyre në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B10

Kryetari të ndërmarrë masa për forcimin e kontroleve të brendshme duke formuar komisionin për inventarizimin e pasurive jofinanciare, dhe të sigurojë inventarizimin në përputhje me dispozitat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Graçanicës në RFV e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë totale prej 6,757,134€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë në vlerë 5,140,267€, të arkëtueshmet nga qiratë në vlerë 27,399€, të arkëtueshmet nga shpronësimi i tokës komunale në vlerë 671,855€, të arkëtueshmet nga taksa për veprimtari në vlerë 888,280€ si dhe llogaritë për gjobat nga inspeksioni 29,333€. Krahasuar me vitin paraprak, llogaritë e arkëtueshme për vitin 2025 janë rritur në vlerë 1,108,674€.

Çështja B11 - Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

- Gjetja** Neni 26 i Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton se “Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove”. Rregulla financiare 03/2010 për të hyrat, përcakton kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake. Në vitin 2025, totali i llogarive të arkëtueshme të komunës arriti në 6,757,134€, prej të cilave 5,140,267€ (76%) i përkasin tatimit në pronë. Krahasuar me vitin 2024, tatimi në pronë shënoi një rritje prej 876,827€, duke reflektuar një trend të vazhdueshëm rritjeje të arkëtimitve komunale. Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të mjaftueshme dhe vazhdueshme të departamenteve përgjegjëse në tentim të mbledhjes së borxheve, po ashtu mungesës së strategjisë për inkasim.
- Ndikimi** Mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson apo edhe pamundëson mbledhjen e tyre.
- Rekomandimi B11** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Poashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	9,753,348	10,824,736	9,848,863	9,323,960	9,318,337
Grante Qeveritare - Buxheti	7,024,142	7,022,255	6,998,486	6,395,178	6,698,911
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,072,956	779,068	1,064,284	655,381
Të hyrat vetanake	2,729,206	2,729,206	2,070,990	1,857,532	1,964,046
Donacionet e jashtme	0	319	319	6,966	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,071,388€. Kjo rritje ishte nga të hyrat vetjake të bartura nga vitet paraprake 1,072,956€, rritje nga donacioneve prej 319€ si dhe zvogëlim i buxhetit nga grandi i Qeverisë prej 1,887€.

Komuna ka shpenzuar rreth 91% të buxhetit final e cila paraqet një performancë të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	9,753,348	10,824,736	9,848,863	9,323,960	9,318,337
Pagat dhe mëditjet	4,513,068	4,511,181	4,511,179	3,987,321	3,713,663
Mallrat dhe shërbimet	1,817,292	1,949,439	1,932,532	1,964,523	1,866,939
Komunalitë	214,000	248,862	248,862	264,851	226,781
Subvencionet dhe transferet	410,859	654,773	600,104	663,854	425,150
Investimet Kapitale	2,708,683	3,371,035	2,556,186	2,443,410	3,085,803
Rezervat	89,446	89,446	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje me vendim të qeverisë ishte zvogëluar për 1,887€, krahasuar me buxhetin fillestar.


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 132,147€. Kjo rritje vjen si rritje nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2024. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për furnizime, pasje të teknologjisë informative, mirëmbajtje dhe servisim, pastrim të objekteve, mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve. Thesari, nga kjo kategori, sipas vendimeve përmbarimore, kishte paguar gjithsej 99,522€, prej të cilave 95,974€, për investimeve kapitale si rezultat i mospagesave me kohë të faturave si dhe 3,548€ për subvencione dhe transfere.

Buxheti final për komunalitet është rritur për 34,862€, nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2024.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 243,914€. Kjo rritje vjen si rritje nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2024. Shpenzimet kanë të bëjë me pagesat e bëra për përkrahjen e OJQ-ve, të individëve si dhe për përkrahjen e qytetarëve që janë me raste sociale.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 662,352€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2024 për 662,033€, si dhe rritje nga donacionet për 319€. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për projektet kapitale si për ndërtimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimin e objekteve, fushave sportive. Vlen të theksohet se thesari, nga kjo kategoritë, në bazë të vendimeve përmbarimore/gjyqësore, ka realizuar pagesa në vlerë prej 580,470€, për faturat të cilat nuk ishin paguar nga komuna brenda afatit të paraparë me ligj.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara në vitin 2025 ishin në vlerë 2,620,784€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2025, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 423,101€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	2,729,206	2,729,206	2,620,784	2,515,547	2,654,690
Të hyrat tatimore	1,228,519	1,228,519	1,227,678	1,244,362	1,140,949
Të hyrat jo tatimore	1,500,687	1,500,687	1,393,106	1,270,917	1,513,740
Të hyrat tjera	0	0		268	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024, kishte rezultuar me 18 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2024 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë, pesë (5) rekomandime ishin zbatuar, një (1) nuk është i aplikueshëm më, një (1) pjesërisht i zbatuar dhe 11 rekomandime nuk ishin zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetarja duhet të sigurojë se për llogaritë e arkëtueshme të raportuara në RFV, komuna posedon dëshmi burimore që konfirmon shumën e borxhit.	Edhe për vitin 2025, komuna nuk ishte në gjendje të na ofronte dokumentacionin që mbështet vlerat e llogarive të arkëtueshme të prezantuar në regjistra e tyre.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për konkluzion	Kryetarja duhet të sigurojë se kontratat e punës/akt emërimet për nëpunësit/zyrtarët komunal përditësohen dhe harmonizohen sipas kërkesave dhe afateve ligjore.	Komuna edhe pse ka ndërmarrë veprime për zbatim të rekomandimit, nga testimet tona audituese kemi identifikuar ende raste të tilla në sektorin e shëndetësisë.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetarja duhet të sigurojë se zyrtarit komunal i aplikohet koeficienti i drejt në pagë sipas përcaktimit ligjor. Poashtu, në formë retroaktive zyrtarit t'i kompensohet diferenca e pagës për të cilën nuk është paguar sipas kërkesave ligjore.	Komuna nuk ka ndërmarrë veprime për zbatim të rekomandimit gjatë vitit 2025.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhet brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbartimore.	Edhe vitin 2025 ishte gjendje e njëjtë në lidhje me këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Baza për konkluzion	Kryetarja duhet të sigurojë se zyra e prokurimit do t'i ndjek të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.	Nuk është i aplikueshëm.	Nuk është i aplikueshëm më
6.	Baza për konkluzion	Kryetarja duhet të sigurojë që Zyra e Prokurimit t'i zbatojë në tërësi kërkesat ligjore gjatë inicimit dhe lidhjes së kontratave publike kornizë, duke mos i përdorur këto kontrata pune për projekte të natyrës ndërtimore.	Nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë testeve tona audituese për vitin 2025.	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Kryetarja duhet të sigurojë që zyrtarët komunal të evidentohen rregullisht në regjistrin e vijueshmërisë për punë dhe kjo të dëshmohet përmes raporteve.	Nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë testeve tona audituese për vitin 2025.	I zbatuar
8.	Baza për konkluzion	Kryetarja duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve. Përditësimi i të dhënave në Protax të bëhet në baza të rregullta periodike.	Sa i përket këtij rekomandimi ne duhet të theksojmë se Ministria e Financave nuk u kishte ofruar databazën e tatimit në pronë komunës me numra personal, për shkak siç theksojnë ato disa ndryshimeve që ishin duke u bërë në sistem.	I zbatuar

9.	Pagat dhe mëditjet	Kryetarja duhet të sigurojë se stafi arsimor dhe shëndetësor të jetë i angazhuar në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë sipas kontratës së punës. Gjithashtu duhet të krijohet harmonizim në mes të pozitave aktuale dhe atyre të buxhetuara në përputhje me ligjin për ndarje buxhetore i cili i përgjigjet nevojave të komunës.	Situata e njëjtë është paraqitur edhe gjatë vitit 2025.	Nuk ka filluar zbatim
10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetarja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Edhe vitin 2025 kishte keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike.	Nuk ka filluar zbatim
11.	Investimet kapitale	Kryetarja duhet të sigurojë që realizimi i kontratave publike kornizë me çmim për njësi të bëhet në pajtueshmëri të plotë me strukturën e peshimeve të specifikuar në kontratë. Në rast të tejkalimit të peshimeve në kategori të caktuara, duhet të ndalohet furnizimi/realizimi vetëm për ato kategori, duke vazhduar me pjesët tjera të kontratës deri në përmbushjen e plotë të kontratës.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2025.	I zbatuar
12.	Investimet kapitale	Kryetarja duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të bëhet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.	Edhe për vitin 2025 ka ende mangësi në menaxhimin e kontratave përmes modulit të e-prokurimit.	Nuk ka filluar zbatim
13.	Investimet kapitale	Kryetarja duhet të forcojë dhe shtojë kontrollet për të siguruar që Zyra e Prokurimit të respektojë plotësisht afatet ligjore të përcaktuara për pranimin e tenderëve, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe konkurrues në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.	Kemi hasur në dy raste të tillë gjatë vitit 2025.	Nuk ka filluar zbatim
14.	Pasuritë	Kryetarja duhet shtuar kontrollet për të siguruar që zyrtarët e pasurive bëjnë azhurnimin e regjistrimit të pasurive, si dhe regjistrimin e të gjitha pasurive dhe stoqeve të komunës, në përputhje me kërkesat ligjore.	Situata vazhdon e njëjtë edhe gjatë vitit 2025.	Nuk ka filluar zbatim
15.	Pasuritë	Kryetarja të ndërmarrë masa për forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim që të sigurohet se komisioni i inventarizimit të pasurive jofinanciare realizon inventarizimin në përputhje me dispozitat ligjore.	Për vitin 2025 nuk ishte formuar komisioni i inventarizimit të pasurisë dhe si rrjedhojë nuk ishte kryer inventarizimi i pasurisë.	Nuk ka filluar zbatim

16.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e kontroleve të brendshme, në mënyrë që të përmirësohet procesi i menaxhimit, prezantimit të drejtë dhe shpalosjes së llogarive të arkëtueshme në RVF.	Edhe për vitin 2025 vazhdon gjendja e njëjtë pasi ka nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimi
17.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Poashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.	Situatë e njëjtë ka vazhduar edhe për vitin 2024 pasi që janë identifikuar mangësi lidhur me menaxhimin e llogarive të arkëtueshme në drejtim të inkasimit.	Nuk ka filluar zbatimi
18.	Detyrimet Kontingjente	Kryetarja duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së RVF, detyrimet kontingjente do të vlerësohen dhe paraqiten me vlera të sakta.	Nga mostrat tona të testuar kemi vërejtur se detyrimet kontingjente ishin paraqitur drejt në regjistrat kontabël dhe në RVF	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Jetmira Isufi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
---------	-----------------	--------------------

<p>Keqklasifikim i shpenzimeve</p>	<p>Në gjetje keni theksuar se komuna kishte paguar 183,184€ nga kategoria Mallra dhe shërbime për kategorinë Investime kapitale që kanë të bëjnë me rikonstruimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale.</p> <p>Me këtë vërejtje mbi gjetjen tuaj, dua të theksoj se nuk bëhet fjalë për rikonstruimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale, por bëhet fjalë për arnimin e gropave në rrugët lokale, gjë që është cekur në kërkesën për rezervimin e mjeteve dhe në raportin e menaxherit të projektit se bëhet fjalë për rinovimin (arnimin e gropave) në rrugët lokale, gjë që nënkupton rikonstruim (mirëmbajtje).</p> <p>Sipas katalogut për kodet ekonomike, të cilin e posedojmë, qëndron se mirëmbajtja dhe riparimet nuk janë investimet kapitale, ndërsa arnimi i gropave konsiderohet si mirëmbajtja e rrugëve lokale.</p> <p>Më datën 11.09.2023, është mbajtur seminari me temën “Prezantimi i Planit të përditësuar kontabël dhe udhëzuesit për Planin kontabël”, i cili është organizuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me mbështetjen e programit USAID-it për administrimin ekonomik në Kosovë, ku janë prezantuar ndryshimet në Planin kontabël për kategoritë ekonomike, si dhe përshkrimi i secilit kod ekonomik në udhëzuesin për Planin kontabël.</p> <p>Të bashkëngjitur po Ju dërgojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kërkesën për rezervimin e mjeteve, ku shihet se bëhet fjalë për arnimin e gropave. - Raportin e menaxherit të projektit, në të cilin ka theksuar se bëhet fjalë për arnimin e gropave. - Ftesën me axhendën për seminarin e mbajtur. - Kopjen e Planit kontabël për kategoritë ekonomike, si dhe përshkrimin për kodin 31230 Rrugët lokale, ku thuhet se nga ky kod përjashtohen shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve të rregullta, të cilat klasifikohen si mallra dhe shërbime. 	<p>Projekti i rikonstruimit dhe asfaltimit të rrugëve lokale përbën një projekt kapital, i cili është planifikuar me Ligjin e Buxhetit. Për këtë arsye, kontrata e lidhur nga zyra e prokurimit është kontratë për punë dhe lidhet me investime kapitale, ndërsa mirëmbajtja dhe riparimi i rrugëve hyjnë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Për më tepër, pozicioni “arnimi i gropave”, të cilin ju e përmendni, nuk është paraparë në kuadër të paramasës dhe paralogarisë së kësaj kontrate.</p> <p>Nga situacionet e punëve të kryera të cilat ishin paguara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve shihet qartë se aty janë kryer punë që kanë të bëjë me: shënjëzimi e trasesë së re dhe urave sipas projektit si dhe monitorimi gjeodezik i elementeve të rrugës gjatë ekzekutimit të punimeve, gërmimin e dheut, largimin e asfaltit ekzistues, blerja e materialit dhe punimi i shtresës përfundimtare nga rëra (0-1)mm para asfaltimit, blerja, transporti dhe shtrimi me makinë finalizuese të shtresës mbajtëse nga asfalti BNS 16 të trashësisë d = 8cm në gjendje kompakte, blerja, transporti dhe shtrimi me makinë finalizuese të shtresës mbajtëse nga asfalti BNS 22 të trashësisë d = 10cm në gjendje kompakte. Blerja, transporti dhe shtrimi me makinë finalizuese të shtresës grisëse nga asfalti i shkrirë AB 11 të trashësisë d = 5cm në gjendje kompakte.</p> <p>Asnjëra nga këto punë nuk kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime, respektivisht me mirëmbajtjen dhe riparimin e rrugëve, por me punë.</p> <p>E gjetura dhe rekomandimi mbetet e pandryshuar.</p>
------------------------------------	--	---

<p>Sistemimi i stafit të sektorit të arsimit dhe shëndetësisë jo në përputhje me kontratat e punës</p>	<p>Duke pasur parasysh faktin se arsimit sipas sistemit serb është edhe një çështje politike, Komuna e Graçanicës ka si qëllim kryesor ta ndihmojë punën e institucioneve parashkollore, shkollave fillore dhe të mesme në territorin e saj në kuptimin teknik, ndërsa nga ana tjetër nuk ka të drejtë t'i emërojë drejtorët e shkollave ose stafin mësimor që punojnë sipas sistemit serb. Në territorin e Komunës së Graçanicës, ka 9 shkolla fillore dhe 8 të mesme që funksionojnë sipas sistemit serb, ndërsa vetëm një shkollë funksionon sipas sistemit të Kosovës, por Komuna e Prishtinës i ka të gjitha kompetencat mbi atë shkollë (punësimin e punëtorëve, mbikëqyrjen dhe menaxhimin). Prandaj, punëtorët e arsimit të Komunës së Graçanicës nuk mund t'i kryejnë punët në shkolla që punojnë sipas një sistemi tjetër. Për këto arsye, si dhe për shkak të faktit se Komuna e Graçanicës nuk ka personel të kualifikuar mjaftueshëm për të punuar në drejtoritë dhe shërbimet komunale, personeli i punësuar në Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Shëndetësisë janë sistemuar përkohësisht në përputhje me nevojat dhe përgatitjen profesionale. Për shembull: juristët në Drejtorinë e Kadastrës, të Urbanizmit, të Inspektionit, inxhinierët në Drejtorinë e Urbanizmit dhe të ngjashme, si dhe sistemimi i përkohshëm i personelit ndihmës në shëndetësi dhe administratë. Komuna e Graçanicës pret përfundimin e Qendrës edukative, e cila do të jetë e destinuar për fëmijët për edukimin dhe zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore. Komuna e Graçanicës do të përpiqet të punësojë një pjesë të personelit mësimdhënës për aktivitetet shtesë dhe jashtëshkollore brenda Qendrës edukative në periudhën e ardhshme. Komuna do të përpiqet ta sistematizojë personelin në fjalë në periudhën e ardhshme në përputhje me kontratat e punës.</p>	<p>Komuna ka dhënë vetëm arsyetime për pa ofruar ndonjë dëshmi që do ta ndryshonte gjetjen tonë. Gjetja e auditimit është vazhdimësi e përsëritur. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.</p>
--	---	--

<p>Aplikimi i koeficientit jo në pajtueshmëri me ligjin për paga</p>	<p>Kjo çështje është ende në fazën e shqyrtimit për disa arsye:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në Komunën e Graçanicës nuk ka institucion të këtij lloji, ku ai mund të punojë si krijues dhe interpretues i artit dhe kulturës. 2. Një pozitë e tillë nuk ekziston dhe nuk është paraparë as me kategorizimin dhe as me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëtorëve. Ai tek ne trajtohet si zyrtar. Ai nuk është klasifikuar si interpretues, krijues i artit dhe nuk i kryen punët e një koreografi, nuk krijon koreografi, puna e tij është administrative. 3. Para hyrjes në fuqi të këtij Ligji të pagave, nuk ka ekzistuar ndonjë ndryshim i madh në koeficient dhe as në përshkrimin e punëve. 4. Zyrtari nuk ka përgatitje adekuate profesionale si krijues dhe interpretues i artit dhe kulturës (kërkohet një shkollë e artit ose Fakulteti i Artit). Ai ka diplomë Master në fushën e Administratës Publike dhe Diplomacisë. Për arsyet e lartpërmendura, ende nuk janë ndërmarrë hapat për zgjidhjen e këtij problemi. Ende po kërkohet një zgjidhje adekuate. <p>Të bashkëngjitur me këto pretendime, po Ju dërgoj si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendimin për kategorizimin e zyrtarëve publikë në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës; - Rregulloren për organizimin e brendshëm të Shtëpisë së kulturës - Përgatitjen profesionale e të punësuarit. 	<p>Komuna, në Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024, ka theksuar se, pas miratimit të rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin, do të përpiqet të harmonizojë pozitën në fjalë. Megjithatë, përkundër miratimit të kësaj rregulloreje gjatë vitit 2025, gjendja nuk ka pësuar ndryshim dhe pozita e të punësuarit me titull koreograf nuk është harmonizuar me Ligjin e Pagave. Gjetja dhe rekomandimi mbetet i pandryshuar.</p>
--	--	--

1667/26 22-04-2026



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAČANICËS
MUNICIPALITY OF GRAČANICA

LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit:

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gračanicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 (në tekstin e mëtejshëm „Raporti“);
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe në vazhdim po i paraqes komentet dhe vërejtjet lidhur me përmbajtjen e draft raportit të marrë nga drejtoritë-shërbimet kompetente;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


Novak Živić
Kryetari i Komunës së Gračanicës,
Data: 22.04.2026, Gračanice



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.